




IFMETALL



7 Arsye e mirë të
jesh në IF Metall







Qartë duhet të jesh me ta!

Pyet ti pse me qenë në sindikatë? A ia vlejnë ato qindëshet? Përgjigja është po - ty të kthehet edhe më shumë, përmes marrëveshjes kolektive dhe anëtarësimit. Kur ne bëhemi shumë dhe qëndrojmë të bashkuar, ne vërtet mund të zhvillojmë bisedime për më shumë të drejta dhe favore, që na duken të qarta, të cilat në rastin e kundërt, ne do t'i humbasim ato. Ka shumë arsye me u anëtarësua në IF Metall. Këto janë disa arsyet më të rëndësishme:



Arka e të papunëve dhe përforcimi i të ardhurave.

Ti mund të marrësh kompensim nga arka jonë e të papunëve, nëse ti e humbet punën. Përveç kësaj, përfshihet edhe një përforcim i të ardhurave, për anëtarët. Ti mund të lexosh më shumë në vazhdim për këtë.




Kushte të mira dhe rrogë të mirë.

Falë marrëveshjeve tona kolektive, ti , në mes tjerave merr, një rrogë të mirë dhe të drejtë, rritje të rregullta të rrogës, orar të arsyeshëm pune, kompensim shtesë për punë jashtë orarit si dhe shkurtim të orarit të punës. Kur të kryesh punën, mund t'ï gëzohesh pensionit, të arritur përmes marrëveshjes.



Një mjedis i sigurt pune.

Një mjedis i mirë pune është i rëndësishëm, për t'ï parandaluar aksidentet dhe sëmundjet. Ne kujdesemi që punëdhënësi zbaton ligjin e mjedisit të punës dhe të ketë përfaqësues mbrojtës që punon për sigurinë tënde dhe që ti të ndjehesh mirë.





Ndihmë dhe mbështetje, kur ka nevojë.

Ne të këshillojmë dhe të japim mbështetje kur të pushojnë nga puna, rehabilitohesh, bashkëbisedime për rrogën, etj. Nëse kërkohet, ti mund të marrësh, edhe ndihmë juridike. Ne, po ashtu, punojmë, që ti të ngrihesh në rolin tënd profesional, që ti të kesh një përgatitje të kërkuar, edhe në të ardhmen.



I siguruar, si në punë dhe gjatë kohës së lirë.

Ti mund të marrësh shpërblim, si për lëndimet në punë si dhe në rast aksidenti, gjatë kohës së lirë, si dhe kur sëmuresh, përmes marrëveshjeve tona kolektive dhe sigurimeve për anëtarët. Kur ti je në pushim prindëror, përveç kësaj, mundesh të marrësh kompensim shtesë.





Ndikim në punë

Në shumë çështje të rëndësishme, ndërmarrësi duhet të bashkëbisedoj me ne në IF Metall, në vendin e punës, para se të merret vendim. Për shembull, bëhet fjalë për ndryshimin e orarit të punës dhe të detyrave të punës, ose si do të zhvillohen rrogat dhe të ndahen ato, në vendin e punës. Si anëtar, mund të ndikosh në këto gjëra.

7



Së bashku jemi të fortë.

Është e vështirë, si i vetëm, t'i kërkes të drejtat tua.
Por ti nuk je i vetëm. Ne jemi 300 000 anëtarë.
Së bashku mund t'i përmirësojmë kushtet,
për të gjithë punëtorët e industrisë dhe të rrisim
drejtësinë në shoqëri.


Si funksionon sigurimi i të ardhurave?

Të gjithë mund ta humbasin punën. Përforsimi ynë i të ardhurave, kompletton arkën e të pa punëve, që të jep ty siguri ekonomike, gjatë kohës që ti kërkon punë të re. Gjithsejtë mund të marrësh deri në 80 përqind të të ardhurave tua bazë, deri në 100 ditë, nëse ti mbetesh i papunë.

Lexo më shumë 1 ifmetall.se/inkomstforsakring 1 ose 2 folksam.se/ifmetall 2

Shembulli 1

Rroga bruto 38 000 kr/muaj.



Sa i lartë është kompensimi?


Nëse ti fiton 1 mbi 1 limitin e arkës së papunëve, ti mundesh me ndihmën e përforcimit të ardhurave të marrësh deri në 80 për qind e të ardhurave* bazë të kompensimit, në mes 33 000 dhe 50 000 korona - që nga dita 1 deri në ditën 100.

2 nëse ti fiton 2 3 nën 3 4 të limitit të arkës së papunëve, ti mund të marrësh deri në 80 për qind 4 nga të ardhurat bazë të kompensimit, në mes të 27 500 dhe 33 000 korona - që nga dita 101 deri në 200 (kur kompensimi nga arka e të papunëve zvogëlohet).

Ka, po ashtu, mundësi të bëhet një sigurim shtesë për 100 ditë shtesë të kompensimit, si dhe të ardhura mbi 50 000 korona.

Shembulli 2

Rroga bruto 31 000 kr/muaj.



* Atë kompensim që arka e të papunëve përllëgarit, bazuar në të ardhurat e tua të dymbëdhjetë muajve të fundit



Modeli suedez

Që nga fundi i vitit 1800, sindikatat suedeze kanë luftuar që punëtorët të kenë rroga të mira dhe kushte të drejta 1 të punës. Krahasuar me shumë vende të tjera, sindikatat suedeze kanë pasur ndikim të madh, fal mirë organizimit tonë, me shumë anëtarë. Kjo na bën të fortë - aq të fortë sa që politikanët nuk kanë nevojë të përzihen, aq shumë, në kushtet tona të punës.

Shumica e gjërave - që nga orari i punës dhe rrogat, deri te pensioni dhe sigurimet - bashkëbisedojmë ne vet duke arritur marrëveshje me punëdhënësit. Dhe kjo është ajo marrëveshja kolektive.

Politikanët mund të përqendrohen në sistemin tonë të mirëqenies dhe të nevojave tona të arsimit, kjo do të thotë, atë bazë që na jep ne, punëtorë të sigurt dhe të aftë Ky zakonisht quhet, modeli suedez.

Ky model kërkon që të jemi shumë anëtarë në sindikata. Kur ne jemi të mirë organizuar dhe kur janë të shumtë ata që qëndrojnë pas kërkesave tona, ne mundemi edhe në vazhdim të jemi një zë i fort dhe të arrihen marrëveshje të forta kolektive, me kushte të drejta dhe me rroga të mira.





Sa kushton?

1 Taksa e anëtarit varet nga të ardhurat tua. Mesatarisht taksa është 1 në IF Metall 1,5 për qind të të ardhurave, çka bëhet 435 korona në muaj, nëse ti fiton 29 000 korona. Për taksën e anëtarit 2 ti merr nga arka e të papunëve një përforsim rroge, nëse ti mbetesh pa punë 2 plus të gjitha të tjerat të rëndësishme, të shkruara në këtë broshurë.

Kështu anëtarësohesh në IF Metall

Është e thjeshtë të anëtarësohesh në IF Metall.



Nëse ti ke BankID, mundesh vet të kërkoesh të bëhesh anëtar në 1 ifmetall.se 1 .

Fol me dëshirë me një përfaqësues të sindikatës, në vendin tënd të punës, ose kontakto repartin tënd lokal të IF Metall, nëse ti ke nevojë për ndihmë me kërkesën.



IFMETALL